

## Fshati SOS

Një shtëpi e dashur për të gjithë....

Organizata jonë i përkushton rëndësi të veçantë grupit më vulnerabël, fëmijëve të cilët si rezultat i arsyeve të ndryshme kanë humbur përkujdesin prindëror. Vetëm pasi janë shqyrtuar të gjitha alternativat për fëmijën si ribashkimi me familjen biologjike, birësimi apo forma të tjera, fëmijët pranohen në SOS Fshatin e Fëmijëve. Përgjatë qëndrimit në përkujdesjen tonë, konsiderohet gjithmonë interesi më i lartë i fëmijës dhe rishqyrtohen me fleksibilitet rastet e fëmijëve.

Qëllimi i SOS Fshatit të Fëmijëve SOS Fshati i Fëmijëve përkujdeset për fëmijë të cilët kanë humbur prindërit e tyre ose nuk mund të jetojnë me prindërit e tyre për arsye të ndryshme dhe si rrjedhojë kanë nevojë për një shtëpi të re dhe të qëndrueshme. Familjet e SOS Fshatit të Fëmijëve e sigurojnë këtë shtëpi, duke zëvendësuar familjen e humbur të fëmijës. Fëmijët integrohen dhe jetojnë në familje dhe mbështeten nëpërmjet planeve individuale të zhvillimit . Modeli i përkujdesjes

SOS Fshati i Fëmijëve përbën formën e përkujdesit shtëpi familje. Gjithshka te ne ndodh si në një familje. Fëmijët jetojnë me nënën SOS, motrat dhe vëllezërit në komunitetin SOS. Parimet 1. Nëna &ndash; Çdo fëmijë ka një prind që kujdeset Nëna SOS krijon lidhje të ngushta me çdo fëmijë që i është besuar asaj dhe u ofron atyre sigurinë, dashurinë dhe stabilitetin për të cilin çdo fëmijë ka nevojë. Si një profesioniste e kujdesit për fëmijë, ajo jeton me to, drejton zhvillimin dhe edukimin e tyre dhe menaxhon shtëpinë &ndash; familje në mënyrë të pavarur duke njohur prejardhjen familjare, rrënjët kulturore dhe besimin fetar të çdo fëmije. 2. Motrat dhe Vëllezërit &ndash; Lidhjet familjare krijohen natyrshëm Vajzat dhe djemtë e moshave të ndryshme jetojnë si vëllezër dhe motra së bashku, me motrat dhe vëllezërit biologjikë që qëndrojnë gjithmonë bashkë në të njëjtën familje SOS. Këta fëmijë dhe nëna e tyre SOS ndërtojnë lidhje emocionale të përjetshme. 3. Shtëpia &ndash; Çdo familje krijon shtëpinë e saj Shtëpia është qendra e jetës familjare me atmosferën e saj unike, me ritmin dhe zakonet e saj. Nën strehën e saj, fëmijët gëzojnë një ndjenjë të vërtetë sigurie dhe përkatësie. Fëmijët rriten bashkë, mësojnë bashkë dhe ndajnë bashkë përgjegjësitë dhe detyrat, ashtu sikurse edhe të gjitha gëzimet dhe brengosjet e ditës. 4. Fshati &ndash; Familja SOS është një pjesë e komunitetit Familjet SOS jetojnë së bashku, duke formuar kështu një komunitet fshati që ofron një atmosferë ku fëmijët gëzojnë një fëmijëri të lumtur. Familjet shkëmbejnë eksperiencë dhe ndihmojnë njëra tjetrën. Ato gjithashtu janë të integruara dhe japin kontributin e tyre në komunitetin lokal. Nëpërmjet familjes së tij ose të saj, nëpërmjet fshatit dhe komunitetit, çdo fëmijë mëson si të jetë një pjesëtar aktiv i shoqërisë.

### Roli i Nënës

Nëna SOS është tipari më dallues i organizatës tonë. Ajo është drejtuesja e Familjes SOS dhe është përgjegjëse për kujdesin dhe zhvillimin e secilit fëmijë që i është besuar asaj. Nënat SOS punojnë së bashku duke ndihmuar dhe mbështetur njëra-tjetrën. Ato zgjedhin një Nënë SOS si përfaqësuese të tyre brenda organizatës. Përgjegjësitë kryesore të Nënës SOS janë të krijojë një shtëpi, të drejtojnë mbajtjen e shtëpisë dhe familjes, të sigurojë mirëqënien e fëmijës duke luajtur rolin e prindit, të zhvillojë vetmirëqënien, të drejtojnë fëmijët në marrjen e përgjegjësive si dhe të ndërveprojë me komunitetin dhe të kontribuojë me të.

### Fazat e Përkujdesjes

“&hellip; Për mendimin tim, nuk ka asgjë më të rëndësishme në botë se sa kujdesi për një fëmijë.” Hermann Gmeiner (Themeluesi i SOS Fshatrave të Fëmijëve)

Fëmijët në përkujdesin tonë ndiqen nëpërmjet Planeve individuale të Zhvillimit ku monitorohet ecuria e mirëritjes dhe zhvillimit të tyre në të gjitha fushat. Një prioritet të veçantë i jepet punës edukative me fëmijët dhe plotësimin të së drejtës së tyre për një arsim cilësor dhe mbështetës. Standartet e SOS Fshatit të Fëmijëve

- SOS modeli familjar i kujdesit për fëmijët përbën kuadrin e punës tonë.
- SOS nëna udhëheq SOS familjen.
- Fëmijët gjejnë strehën e tyre në SOS familje që plotëson më së miri nevojat e tyre.
- Zhvillimi i fëmijës mbështetet aktivisht.

- Programet e rinisë ofrojnë mundësi vetëzhvillimi.
- Çdo SOS familje jeton si pjesë e komunitetit.
- Fondet dhe pasuria përdoren me përgjegjshmëri
- Planifikimi dhe vlerësimi sigurojnë një mjedis cilësor përkujdesjeje për fëmijët
- Rritja dhe zhvillimi i secilit punonjës mbështetet aktivisht.
- Drejtori i Fshatit udhëheq SOS Fshatin e Fëmijëve

Vendndodhja Në SOS Fshatin e Fëmijëve funksionojnë 13 familje/vila mikpritëse për fëmijët që kanë humbur përkujdesin prindëror. Fshati SOS është i vendosur në zonën e Saukut me kapacitet për 91 fëmijë. Brenda infrastrukturës së SOS Fshatit janë të përfshira edhe SOS Shkolla dhe SOS kopështi. Kontakt Mimoza Manaj Drejtoresha e SOS Fshatit të Fëmijëve Tiranë Tel: +355 246 7680 ext 225 Email: [mimozamanaj@soskd.org.al](mailto:mimozamanaj@soskd.org.al) Lexoni një Histori personale duke klikuar këtu .